

PHILIPS

Mbi vesh

Seria 8000

TAPH805



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në
www.philips.com/support

Përmbajtja

1	Udhëzime të rëndësishme	2
	sigurie	2
	Siguria për dëgjimin	2
	Informacione të përgjithshme	2
2	Kufje mbi vesh me Bluetooth	3
	Çfarë ka në kuti	3
	Pajisje të tjera	3
	Përmbledhje për kufjen me Bluetooth	4
3	Fillimi	5
	Karikimi i baterisë	5
	Çiftimi i kufjeve me telefonin celular	5
4	Përdorimi i kufjes	6
	Lidhja e kufjes me pajisjen me Bluetooth	6
	Menaxhimi i telefonatave dhe muzikës	6
5	Të dhëna teknike	8
6	Njoftim	9
	Deklarata e konformitetit	9
	Hedhja e produktit dhe baterisë të vjetër	9
	Pajtueshmëria me EMF	9
	Informacione mjedisore	9
	Njoftim pajtueshmërie	10
7	Markat tregtare	11
	Bluetooth	11
	Siri	11
	Google	11
8	Pyetje të bëra shpesh	12

1 Udhëzime të rëndësishme sigurie

Siguria për dëgjimin



Rrezik

- Për të shmangur dëmtimin në dëgjim, kufizoni kohën që e përdorni kufjet me volum të lartë dhe vendoseni volumin në një nivel të sigurt. Sa më i lartë të jetë volumi, aq më e shkurtër të jetë koha e dëgjimit.

Sigurohuni të ndiqni udhëzimet e mëposhtme kur e përdorni kufjen.

- Dëgjoni me volum të arsyeshëm për periudha kohe të arsyeshme.
- Bëni kujdes të mos e ngrini vazhdimisht volumin derisa veshi juaj të përshtatet me volumin.
- Mos e ngrini volumin kaq shumë saqë të mos dëgjoni çfarë ka rreth jush.
- Duhet të bëni kujdes ose të mos e përdorni përkohësisht në situata që mund të jenë të rrezikshme.
- Presioni i tepërt i tingullit nga kufjet mund të shkaktojë humbje të dëgjimit.
- Përdorimi i kufjeve me të dy veshët e mbuluar gjatë drejtimit të automjetit nuk rekomandohet dhe mund të jetë i jashtëligjshëm në disa zona.
- Për sigurinë tuaj, shmangni përqendrimet nga muzika ose

telefonatat ndërsa jeni në trafik ose në ambiente që mund të jenë të rrezikshme.

Informacione të përgjithshme

Për të shmangur dëmtimet ose defektet:



Kujdes

- Mos i ekspozoni kufjet në nxehtësi ekstreme
- Mos i rrëzoni kufjet.
- Kufjet nuk duhet të ekspozohen ndaj spërkatjeve ose lëngjeve.
- Mos lejoni që kufjet të zhyten në ujë.
- Mos përdorni agjentë pastrimi që përmbajnë alkool, amoniak, benzen ose gërryes.
- Nëse është e nevojshme ta pastroni, përdorni një leckë të butë të njomur me sasi minimale uji ose detergjent të butë.
- Bateria e brendshme nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësive të tepërta si për shembull drita e diellit, zjarri ose të ngjashme.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria nuk vendoset si duhet. Ndërrojeni vetëm me bateri të njëjtë ose me të njëjtin tip.
- Asnjëherë mos i përdorni kufjet kur përdorni një automjet motorik, kur ngisni biçikletën, kur vraponi ose kur ecni në zona me lëvizje. Është e rrezikshme dhe e jashtëligjshme në shumë vende.


Të dhëna rreth temperaturave dhe lagështisë për operimin dhe ruajtjen

- Temperatura e operimit: 0°C (32°F) deri në 40°C (104°F)
- Temperatura e ruajtjes: -10°C (14°F) deri në 45°C (113°F)
- Lagështia e operimit: 8% - 90% RH (Pa kondensim)
- Lagështia e ruajtjes: 5% - 90% RH (Pa kondensim)
- Lartësia maksimale e operimit: 3000 m
- Jetëgjatësia e baterisë mund të jetë më e shkurtër në kushte temperature të lartë ose të ulët.

2 Kufje mbi vesh me Bluetooth

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni produktin në www.philips.com/welcome. Me këto kufje Philips për përdorim sipër veshëve, ju mund të:


- bëni telefonata pa duar;
- dëgjoni dhe kontrolloni muzikën me valë;
- kaloni mes telefonatave dhe muzikës;
- kënaqeni me anulimin e zhurmës.



Kabllo audio



Manuali i përdorimit




Kasa e karikimit

Çfarë ka në kuti



Kufje Philips Bluetooth sipër veshëve TAPH805





Kabli i karikimit me USB (vetëm për karikim)

Pajisje të tjera

Një celular ose pajisje portative (p.sh. Notebook, PDA, adaptorë Bluetooth, aparate MP3, etj.) që mbështet Bluetooth dhe është i pajtueshëm me kufjen (shiko “Të dhëna teknike” në faqen 8).

Përmbledhje për kufjen me Bluetooth



- ① Paneli i kontrollit me prekje
- ② Xhek audio
- ③ Mikrofon
- ④ Treguesi LED
- ⑤ ANC/Treguesi LED i zhurmës së ambientit
- ⑥ ⏻ (Butoni i energjisë)
- ⑦ Vendi i karikimit micro

3 Fillimi

Karikimi i baterisë

Shënim

- Para se ta përdorni kufjen për herë të parë, vendosini kufjet në kasën e karikimit dhe karikoni baterinë për 3 orë që bateria të ketë kapacitet dhe jetëgjatësi optimale.
- Përdorni vetëm kablhin origjinal USB të karikimit për të shmangur çfarëdo dëmtimi.
- Mbaroni telefonatën para se ta karikoni kufjen, pasi lidhja e kufjes për karikoni kufjen pasi karikimi do ta fikë kufjen.

Kasa e karikimit

Lidhni kablhin USB të karikimit që ju është dhënë me:

- vendin e karikimit micro USB në kufje dhe;
 - karikuesin/portën USB të një kompjuteri.
- ↳ Drita LED ndizet në ngjyrë të kuqe gjatë karikimit dhe fiket kur kufjet janë të karikuara plotësisht.

Këshillë

- Normalisht, karikimi i plotë zgjat 2 orë.

Çiftimi i kufjeve me telefonin celular

Para se t'i përdorni kufjet me telefonin celular për herë të parë, çiftojini me një telefon celular. Një çiftim i suksesshëm bën të mundur një lidhje unike të enkriptuar mes kufjeve dhe telefonit celular. Kufjet ruajnë në memorie 8 pajisjet e fundit. Nëse mundoheni të çiftoni më shumë se 8 pajisje, pajisja e çiftuar e para zëvendësohet me atë më të fundit.

- 1 Sigurohuni që kufjet janë karikuar plotësisht dhe janë të fikura.
- 2 Shtypni dhe mbani shtypur  për 5 sekonda derisa dritat LED ngjyrë blu dhe të kuqe të pulsojnë me radhë.
↳ Kufjet qëndrojnë në modalitetin e çiftimit për 2 minuta.
- 3 Sigurohuni që telefoni celular është i ndezur dhe që Bluetooth është i aktivizuar.
- 4 Çiftoni kufjet me telefonin celular. Për informacione të hollësishme, shikoni manualin e celularit tuaj.

Shembulli i mëposhtëm tregon se si t'i çiftoni kufjet me telefonin celular.

- ↳ Aktivizoni veçorinë Bluetooth të celularit tuaj, zgjidhni **Philips PH805**.



Philips PH805

4 Përdorimi i kufjes

Lidhja e kufjes me pajisjen me Bluetooth

- 1 Ndizni celularin/pajisjen Bluetooth.
- 2 Shtypni dhe mbani shtypur butonin e ndezjes/fikjes për t'i ndezur kufjet.
 - ↳ Drita LED ngjyrë blu ndizet për 3s.
 - ↳ Kufjet lidhen përsëri automatikisht me telefonin celular/pajisjen Bluetooth që ishte lidhur për herë të fundit.



Këshillë

- Nëse e ndizni telefonin celular/pajisjen me Bluetooth ose aktivizoni Bluetooth pasi keni ndezur kufjet, duhet t'i lidhni përsëri manualisht kufjet dhe telefonin celular/pajisjen me Bluetooth.



Shënim

- Nëse brenda 2 minutash kufjet nuk lidhen me pajisjen me Bluetooth me të cilën janë lidhur për herë të fundit, ato do të kalojnë në modalitetin e çiftimit, pastaj do të fiken automatikisht nëse nuk lidhen me asnjë pajisje me Bluetooth 8 minuta më vonë kur ANC është i fikur.
- Nëse kufjet nuk kanë asnjë histori lidhjeje dhe nuk lidhen me asnjë pajisje me Bluetooth brenda 2 minutash, ato do të ndalojnë çiftimin dhe do të kalojnë në gjendje pritjeje.

Lidhja me kabëll

Mund t'i përdorni kufjet me kabllon audio që është dhënë. Lidhni kabllon audio me kufjet dhe me pajisjen e jashtme audio.



Këshillë

- Butonat e funksioneve do të jenë të çaktivizuar kur përdorni modalitetin line-in.

Menaxhimi i telefonatave dhe muzikës

Ndezje/fikje

Detyra	Butoni	Përdorimi
Ndizni kufjet.	Butoni i energjisë	Shtypeni dhe mbajeni shtypur për 3 sekonda.
Fikini kufjet.	Butoni i energjisë	Shtypeni dhe mbajeni shtypur për 3 sekonda. ↳ Drita LED blu është e ndezur dhe zbehet.

Kontrolli i muzikës

Detyra	Butoni	Përdorimi
Luani ose ndaloni muzikën.	Paneli i kontrollit me prekje	Mbulo njëherë
Rregullimi i volumnit.	Paneli i kontrollit me prekje	Lëvizni lart / Lëvizni poshtë
Kënga tjetër.	Butoni i energjisë	Shtyjeni poshtë
Kënga e mëparshme.	Butoni i energjisë	Shtyjeni lart

Kontrolli i telefonatës

Detyra	Butoni	Përdorimi
Përgjigjuni / mbylleni një telefonatë.	Paneli i kontrollit me prekje	Mbulo njëherë
Refuzoni një telefonatë.	Paneli i kontrollit me prekje	Mbulo & Mbaj 2"
Përgjigjuni një telefonatë të re gjatë një telefonate tjetër.	Paneli i kontrollit me prekje	Mbulo njëherë

Detyra	Butoni	Përdorimi
Refuzoni një telefonatë të re gjatë një telefonate tjetër.	Paneli i kontrollit me prekje	Mbulo & Mbaj 2"
Mbylleni telefonatën aktuale dhe bëjeni aktive telefonatën tjetër	Paneli i kontrollit me prekje	Mbulo njëherë
Ndryshoni telefonatën kur i jeni përgjigjur dy telefonatave	Paneli i kontrollit me prekje	Mbulo & Mbaj 2"
Ndryshoni telefonin dhe kufjen kur jeni gjatë një telefonate	Paneli i kontrollit me prekje	Mbulo & Mbaj 2"

Kontrolli ANC

Detyra	Butoni	Përdorimi
ANC NDEZUR / FIKUR / Zhurma e ambientit	Butoni i energjisë	Shtyp njëherë

Google Assistant

Detyra	Butoni	Përdorimi
Zgjo Google Assistant	Paneli i kontrollit me prekje	Mbulo & Mbaj

Statusi i treguesit të kufjes tjetër

Statusi i kufjeve	Treguesi
Kufjet janë të lidhura me një pajisje Bluetooth, ndërsa kufjet janë në gjendje pritjeje ose ndërsa dëgjoni muzikë.	Drita LED blu është e ndezur.
Kufjet janë gati për çiftim.	Drita LED pulson ngjyrë blu dhe të kuqe me radhë.
Kufjet janë të ndezura por nuk janë të lidhura me pajisjen Bluetooth.	Drita LED e kuqe pulson me ngadalë. Nëse nuk mund të bëhet asnjë lidhje, kufjet do të fiken vetë brenda 8 minutash kur ANC është i fikur.
Nivel i ulët i baterisë	Drita LED e kuqe pulson çdo 2 sekonda derisa t'i mbarojë energjia
Bateria është e karikuar plotësisht.	Drita LED është e fikur.

5 Të dhëna teknike

Kufja

- Koha e muzikës: 30 orë
Koha e bisedës: 30 orë
- Koha në gjendje pritjeje: 160 orë
Koha e karikimit: 2 orë
- Bateri e karikueshme me polimere litiumi (680 mAh)
- Versioni i Bluetooth: 5.0
Profilat e pajtueshme të Bluetooth:
 - HFP (Hands-Free Profile)
 - A2DP (Advanced Audio Distribution Profile)
 - AVRCP (Audio Video Remote Control Profile)
- Audio-codec i mbështetur: SBC
- Gama e frekuencës: 2,402-2,480 GHz
- Fuqia e transmetuesit: < 10 dBm
- Gama e operimit: Deri në 10 metra (33 këmbë)
- Reduktim i ekos dhe zhurmës digjitale
- Fikje automatike
- Porta Micro-USB për karikim
- Mbështet SBC
- Paralajmërim për bateri të ulët: i disponueshëm



Shënim

- Specifikimet mund të ndryshohen pa u njoftuar.

6 Njoftim

Deklarata e konformitetit

Këtu, MMD Hong Kong Limited deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EU. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.p4c.philips.com.

Hedhja e produktit dhe baterisë të vjetër



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Ky simbol mbi një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.




Ky simbol do të thotë se produkti përmban një bateri të rikarikueshme të brendshme që mbulohet nga Direktiva Evropiane 2013/56/EU e cila nuk mund të hidhet së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Ju këshillojmë fort që ta çoni produktin në një pikë zyrtare grumbullimi ose në një qendër shërbimi Philips për ta hequr baterinë e rikarikueshme në mënyrë profesionale. Informohuni lidhur me sistemin e grumbullimit të veçantë në zonën tuaj për produktet elektrike dhe elektronike dhe bateritë e rikarikueshme. Ndiqui rregullat lokale dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë e

karikueshme së bashku me mbeturinat e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra dhe e baterive të rikarikueshme ndihmon në parandalimin e pasojave negative ndaj mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Heqja e baterisë së brendshme

Nëse në vendin tuaj nuk ka sistem grumbullimi/riciklimi për produktet elektronike, mund ta mbronj mjedisin duke hequr dhe ricikluar baterinë para se t'i hidhni kufjet.

- Sigurohuni që kufja të jetë e shkëputur nga kasa e karikimit para se të hiqni baterinë.



Pajtueshmëria me EMF

Ky produkt i përmbahet të gjitha standardeve dhe rregullave lidhur me ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin që të ndahet me lehtësi në tre materiale: karton (kutia), polistirol (amortizuesi) dhe polietilen (qeset, fletë mbrojtëse sfungjeri).

Sistemi përbëhet nga materiale të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju lutemi ndiqni rregullat vendëse lidhur me hedhjen e materialeve të paketimit, baterive të konsumuara dhe pajisjeve të vjetra.

Njoftim pajtueshmërie

Pajisja i përmbahet rregullave FCC, pjesa 15. Operimi është subjekt i dy kushteve të mëposhtme:

1. Kjo pajisje nuk mund të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe
2. Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojë operim të padëshiruar.

Rregullat FCC

Kjo pajisje është testuar dhe është zbuluar se i përmbahet limiteve për një pajisje digjitale të Kategorisë B, sipas pjesës 15 të rregullave FCC. Këto limite janë bërë për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencës së dëmshme në një ambient banimi. Kjo pajisje gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji frekuence radioje dhe, nëse nuk instalohet dhe përdoret në përputhje me manualin e udhëzimeve, mund të shkaktojë interferencë të dëmshme ndaj komunikimeve radio. Megjithatë, nuk ka garanci se nuk do të ketë interferenca në një ambient të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton interferenca të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë që mund të përcaktohet duke e fikur dhe ndezur pajisjen, përdoruesi nxitet që të përpiqet ta korrigjojë interferencën duke ndjekur një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

- Ndryshoni orientimin ose lëvizeni antenën.
- Rritni hapësirën mes pajisjes dhe marrësit.

- Lidhjeni pajisjen me një prizë në një qark elektrik që është ndryshe nga ai që është lidhur marrësi.
- Konsultohuni me shitësin ose me një teknik të kualifikuar të radiove/televizorëve për ndihmë.

Deklarata e FCC për ekspozimin ndaj rrezatimit:

Kjo pajisje i përmbahet limiteve të FCC për ekspozimin ndaj rrezatimit të përcaktuar për një mjedis të pakontrolluar.

Transmetuesi nuk duhet të ndodhet në të njëjtin vend me ndonjë antenë ose transmetues tjetër apo të punojë bashkë me to.

Kujdes: Përdoruesi paralajmërohet se ndryshimet ose modifikimet që nuk janë miratuar shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund ta bëjnë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për të operuar pajisjen.

Kanada:

Kjo pajisje përmban transmetues/marrës të përjashtuar nga licencat të cilat i përmbahen RSS-ve të Inovacionit, Shkencës dhe Zhvillimit Ekonomik të Kanadasë të përjashtuar nga licencat. Përdorimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme: (1) kjo pajisje nuk mund të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe (2) kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë operim të padëshiruar të pajisjes. CAN ICES-3(B)/NMB-3(B)

Deklarata e IC për ekspozimin ndaj rrezatimit:

Kjo pajisje i përmbahet limiteve të Kanadasë për ekspozimin ndaj rrezatimit të përcaktuar për mjedise të pakontrolluara.

Transmetuesi nuk duhet të ndodhet në të njëjtin vend me ndonjë antenë ose transmetues tjetër apo të punojë bashkë me to.

7 Markat tregtare

Bluetooth

Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka të regjistruara tregtare që zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga Top Victory Investment Limited bëhet me licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë u përkasin pronarëve të tyre përkatës.

Siri

Siri është një markë tregtare e Apple Inc., e regjistruar në SHBA dhe në shtete të tjera.

Google

Google është markë e Google LLC. Google Assistant nuk është i disponueshëm në disa gjuhë dhe shtete të caktuara.

8 Pyetje të bëra shpesh

Kufjet e mia me Bluetooth nuk ndizen
Niveli i baterisë është i ulët. Karikoni kufjet.

Nuk i çiftoj dot kufjet e mia me Bluetooth me pajisjen time me Bluetooth.

Bluetooth është i çaktivizuar. Aktivizoni Bluetooth në pajisjen tuaj me Bluetooth dhe ndizeni pajisjen me Bluetooth para se të ndizni kufjen.

Si të bëni reset të çiftimit.

Lërimi kufjet të qëndrojnë në modalitetin e çiftimit (drita pulson me radhë në ngjyrë të kuqe dhe blu), shtypni butonin e energjisë  dhe mbajeni shtypur, shtypni dy herë panelin e kontrollit, pastaj drita LED lela do të pulsojë 3 herë.

Dëgjoj por nuk mund ta kontrolloj muzikën në pajisjen time Bluetooth (p.sh. luaj/pauzë/kapërce përpara/mbrapa).

Sigurohuni që burimi audio Bluetooth mbështet AVRCP (shiko “Të dhëna teknike” në faqen 8).

Niveli i volumit të kufjeve është shumë i ulët.

Disa pajisje me Bluetooth nuk e lidhin dot nivelin e volumit me kufjen me anë të sinkronizimit të volumit. Në rast të tillë, duhet të rregulloni veçmas volumnin në pajisjen me Bluetooth për ta çuar volumnin në nivel të përshtatshëm.

Pajisja me Bluetooth nuk e gjen dot kufjen.

- Kufjet mund të jenë lidhur me një pajisje të çiftuar më parë. Fikeni pajisjen e lidhur ose largojeni nga rrezja.
- Çiftimi mund të jetë fshirë ose kufja është çiftuar më parë me një pajisje tjetër. Çiftojeni përsëri kufjen me pajisjen me Bluetooth siç tregohet në manual. (shikoni “Çiftimi i kufjes me pajisjen Bluetooth për herë të parë” në faqen 6).

Kufja ime me Bluetooth është e lidhur me një telefon celular me Bluetooth stereo, por muzika luhet vetëm në boksën e celularit tim.

Shikoni manualin e përdorimit të celularit. Zgjidhni të dëgjoni muzikë përmes kufjes.

Cilësia e audios është e dobët dhe mund të dëgjohej zhurmë kërcitjeje.

- Pajisja Bluetooth është jashtë rrezes. Afroni kufjen dhe dhe pajisjen Bluetooth, ose largoni pengesat mes tyre.
- Karikoni kufjen.

Cilësia e audios është e dobët kur streaming nga celulari është shumë i ngadaltë, ose streaming audio nuk punon fare.

Sigurohuni që telefoni celular mbështet jo vetëm (mono) HFP, por mbështet edhe A2DP dhe është i pajtueshëm me BT4.0x (ose më i lartë) (shiko “Të dhëna teknike” në faqen 8).

Për ndihmë të mëtejshme, vizitoni www.philips.com/support.



Este equipamento não tem direito à proteção contra interferência prejudicial e não pode causar interferência em sistemas devidamente autorizados.

Este produto está homologado pela ANATEL, de acordo com os procedimentos regulamentados pela Resolução 242/2000, e atende aos requisitos técnicos aplicados. Para maiores informações, consulte o site da ANATEL: www.anatel.gov.br

Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt.

